



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI

URDHËR

Nr. 670, datë 22.04.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT DISIPLINOR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 13, pika 2, shkronja “f” të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 8, pika 4, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Me këtë rregullore të njihet i gjithë personeli i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.
3. Përgjigjen për zbatimin e kësaj rregulloreje ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.
4. Ndjekin zbatimin e kësaj rregulloreje Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Komandantët e Forcave dhe Strukturave Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MIMI KODHELI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES**

RREGULLORE

“PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN

DHE

PËRBËRJEN E KOMISIONIT DISIPLINOR”

Miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes

nr. ____ datë __.__.2015

Tiranë 2015

PËRMBAJTJA

Kreu I: Dispozita të përgjithshme

- Neni 1: Baza ligjore
- Neni 2: Objekti
- Neni 3: Qëllimi
- Neni 4: Subjektet
- Neni 5: Juridiksioni territorial

Kreu II: Organizimi dhe përbërja e komisionit disiplinor

- Neni 6: Organizimi
- Neni 7: Subjektet që kërkojnë ngritjen e komisionit disiplinor
- Neni 8: Autoriteti për ngritjen e komisionit disiplinor
- Neni 9: Përbërja e komisionit disiplinor
- Neni 10: Rastet e papajtueshmërisë
- Neni 11: Urdhri për ngritjen e komisionit disiplinor dhe shqyrtimin e ankesës
- Neni 12: Oficeri disiplinor
- Neni 13: Dokumentacioni dhe procedura e hetimit disiplinor
- Neni 14: Marrja e deklarimeve nga oficeri disiplinor
- Neni 15: E drejta e ushtarakut për tu mbrojtur

Kreu III: Funksionimi i komisionit disiplinor

- Neni 16: Funksionet e komisionit disiplinor
- Neni 17: Procedura e komisionit disiplinor
- Neni 18: Mungesa e ushtarakut ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore
- Neni 19: Thirrja dhe pyetja e dëshmitarëve gjatë seancës disiplinore
- Neni 20: Shtyrja e afatit të shqyrtimit disiplinor
- Neni 21: Marrja e vendimit nga komisioni disiplinor
- Neni 22: Zbatimi i rregullores

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor”, bazohet në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është organizimi, përbërja dhe funksionimi i Komisionit Disiplinor në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” për shqyrtimin e ankesave të ushtarakëve që janë ndëshkuar me masë të rëndë disiplinore.

Neni 3 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin juridik dhe përcaktimin e veprimeve procedurale për shqyrtimin e ankimit nga ushtaraku i ndëshkuar me masë të rëndë disiplinore, duke garantuar të drejtën e ushtarakut për t’u informuar, ankuar dhe për t’u mbrojtur ndaj masës disiplinore të dhënë.

Neni 4 Subjektet

Subjekt i kësaj rregulloreje janë ushtarakët aktiv të Forcave të Armatosura, kursantët, si dhe ushtarakët në rezervë kur janë në shërbim ushtarak për stërvitje ose shërbim gjatë një mobilizimi ushtarak të cilët janë ndëshkuar me masë disiplinore të rëndë nga komandantët në nivel batalioni, komandantët në nivel Force, strukture mbështetëse apo strukturë e varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 5 Juridiksioni territorial

Kjo rregullore është e zbatueshme për ushtarakët shqiptarë që kryejnë shkelje disiplinore të rënda si brenda dhe jashtë vendit të cilët kanë marrë masë disiplinore nga autoriteti përgjegjës, përveç rasteve kur autoriteti përgjegjës është Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

KREU II ORGANIZIMI DHE PËRBËRJA E KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 6 Organizimi

1. Në strukturat e Forcave të Armatosura për shqyrtimin e ankimit ndaj masave të rënda disiplinore ngrihet dhe funksionon komisioni disiplinor.
2. Komisioni disiplinor organizohet dhe funksionon në strukturat në nivel:
 - a. Komandë force dhe strukturë mbështetëse, kur masa është dhënë nga komandantët në nivel batalioni;
 - b. Shtabi Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, kur masa është dhënë nga komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse apo strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 7 Subjektet që kërkojnë ngritjen e komisionit disiplinor

1. Ngritja e komisionit disiplinor kërkohet nga ushtaraku i cili ankimon një masë të rëndë disiplinore të dhënë ndaj tij.
2. Kërkesa për ngritjen e komisionit disiplinor bëhet brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për masën disiplinore të dhënë.
3. Format i kërkesës përcaktohet në formularin KD Model-1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.

Neni 8 Autoriteti për ngritjen e komisionit disiplinor

1. Autoriteti për ngritjen e komisionit disiplinor është komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.
2. Urdhri për ngritjen e komisionit disiplinor miratohet brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit në sekretarinë e autoritetit të cilit i drejtohet ankimi.
3. Punonjësi i sekretarisë i jep ankuesit një vërtetim për datën e regjistrimit të ankesës dhe e dërgon ankesën menjëherë tek autoriteti përgjegjës.

Neni 9 Përbërja e komisionit disiplinor

1. Komisioni disiplinor ka në përbërje jo më pak se tre oficerë të strukturës përkatëse, me grada të njëjta ose më të larta se ato të ushtarakut ndaj të cilit do të procedohet disiplinarisht.
2. Komisioni disiplinor duhet të ketë në përbërje minimalisht dy oficerë me gradë të lartë.

3. Nëse ushtaraku që bën ankim është ushtar ose nënoficer, numri i anëtarëve të komisionit disiplinor shtohet me dy anëtarë nga të cilët të paktën njëri është nënoficer me gradë të njëjtë ose më të lartë se ushtaraku ndaj të cilit kryhet procedimi disiplinor.
4. Në komisionin disiplinor numri i nënoficerëve nuk mund të jetë më i madh se numri i oficerëve.
5. Kryetari i komisionit disiplinor caktohet një oficer me gradë jo më të ulët se gradat e anëtarëve të komisionit, e ushtarakut që ka kryer shkeljen dhe e mbrojtësit të tij.
6. Numri i anëtarëve të komisionit disiplinor duhet të jetë gjithmonë një numër tek.

Neni 10 **Rastet e papajtueshmërisë**

1. Nuk mund të jetë pjesë e komisionit disiplinor ose oficer disiplinor:
 - a. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
 - b. eprori ose vartësi i drejtpërdrejtë i ushtarakut që ka kryer shkeljen disiplinore;
 - c. ushtaraku që ka bërë kërkesën për shqyrtimin e shkeljes disiplinore;
 - ç. ushtaraku që ka informuar, konstatuar apo që është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga shkelja disiplinore;
 - d. ushtaraku që ka lidhje familjare/gjaku deri në shkallën e tretë, apo bashkëjeton me ushtarakun që ka kryer shkeljen disiplinore;
 - dh. ushtaraku që ka qenë oficer disiplinor në shqyrtimin e një shkelje disiplinore të mëparshme të të njëjtit ushtarak brenda një harku kohor prej 12 muajsh;
 - e. ushtaraku i pa rehabilituar sipas nenit 23, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;
 - ë. ushtaraku që vetë ose pjesëtarët e familjes së tij kanë interesa ekonomike e financiare të përbashkëta me ushtarakun që ka kryer shkeljen disiplinore;
 - f. ushtarakët që frekuentojnë kurset institucionale.
2. Ushtaraku që ankohet ka të drejtë që në çdo kohë të kërkojë papajtueshmërinë e krijuar me kryetarin/anëtarin e komisionit disiplinor dhe/ose oficerin disiplinor, tek autoriteti përgjegjës për ngritjen e komisionit të disiplinor. Kërkesa duhet të jetë e motivuar.
3. Format i kërkesës përcaktohet në formularin KD Model-2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.
4. Kryetari/anëtarin e komisionit disiplinor dhe/ose oficerin disiplinor kur konstaton se ka papajtueshmëri i paraqet dorëheqjen autoritetit përgjegjës për ngritjen e komisionit disiplinor.
5. Nëse verifikohet papajtueshmëria, autoriteti përgjegjës merr masa të menjëhershme për zëvendësimin e kryetarit/anëtarit të komisionit disiplinor dhe/ose oficerit disiplinor.

Neni 11

Urdhri për ngritjen e komisionit disiplinor dhe shqyrtimin e ankesës

1. Urdhri i autoritetit përgjegjës për ngritjen e komisionit disiplinor dhe shqyrtimin e ankesës, duhet të përmbajë:
 - a. emërtimin e urdhrin me emrin dhe mbiemrin e ushtarakut që ka paraqitur ankim;
 - b. masën disiplinore që do të bëhet objekt shqyrtimi;
 - c. përbërjen nominale dhe funksionale të anëtarëve dhe kryetarit të komisionit disiplinor;
 - ç. kohën e fillimit dhe përfundimit të procedurës së shqyrtimit të masës disiplinore, e cila nuk duhet të jetë më shumë se 27 ditë kalendarike nga data e depozitimit të ankimit;
 - d. oficerin disiplinor që do të përfaqësojë në komisionin disiplinor autoritetin përgjegjës që ka dhënë masën për të cilën është bërë ankim;
 - dh. sekretarin e komisionit, i cili mban procesverbalin e seancave.
2. Formati i urdhrin përcaktohet në formularin KD Model-3, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.
3. Ushtaraku i cili ka ankimuar masën disiplinore njihet me urdhrin për ngritjen e Komisionit Disiplinor nëpërmjet sekretarisë së strukturës përkatëse.

Neni 12 Oficeri disiplinor

1. Oficeri disiplinor është përfaqësues i autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore dhe kryen hetimin e shkeljes disiplinore nga ushtaraku. Hetimi shërben për të vërtetuar shkeljen disiplinore për të cilin është marrë masa disiplinore.
2. Oficeri disiplinor duhet të jetë oficer me gradë të lartë ose oficer me gradë kapiten që të ketë përfunduar arsimin e lartë juridik.
3. Oficeri disiplinor fillon hetimin disiplinor nga data e daljes së urdhrin për ngritjen e komisionit disiplinor dhe zhvillon hetimin brenda një afati kohor prej 15 ditësh kalendarike.

Neni 13 Dokumentacioni dhe procedura e hetimit disiplinor

1. Oficeri disiplinor gjatë hetimit disiplinor kryen këto procedura:
 - a. njihet me dokumentacionin e praktikës për masën disiplinore të dhënë;
 - b. kryhen hetime, merr dëshmi dhe mbledh dokumentacion shtesë që i shërben hetimit;
 - c. fton ushtarakun ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore që të njihet me aktet dhe dokumentet që janë mbledhur kundrejt tij, duke e informuar për të drejtën e njohjes dhe mbajtjes së shënimeve ose marrjen e kopjeve të dokumentacionit;
 - ç. fton ushtarakun ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore të sjellë pretendime dhe dokumentacione të tjera për shkeljen e kryer, të përcaktojë ku dhe/ose ndaj kujt dëshiron që të kryhen verifikime dhe hetime të tjera ose të merren dëshmi;
 - d. kryhen verifikimet dhe hetimet e mëtejshme të kërkuara nga ushtaraku ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore;

- dh. përgatit relacionin përmblyllës me përfundimet e nxjerra dhe formulon propozimet e tij;
 - e. fton sërish ushtarakun ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore të shohë aktet dhe relacionin përmbledhës dhe të japë me shkrim brenda një afati prej dy ditëve pune pretendimet e tij përfundimtare;
 - ë. inventarizon të gjitha aktet e hetimit disiplinor që duhet të jenë të numëruara.
2. Oficeri disiplinor krijon fashikullin hetimor disiplinor i cili ka në përbërje:
 - a. kopje të praktikës së dokumentacionit për masën disiplinore të dhënë;
 - b. dokumentet e kërkuara ose ato që mendohet se janë të nevojshme;
 - c. gjithë dokumentacionet dhe aktet e mbledhura gjatë hetimit disiplinor;
 - ç. relacioni përmbledhës për hetimin disiplinor;
 - d. procesverbali i njohjes me aktet e mbledhura gjatë hetimit disiplinor.
 3. Formati i procesverbalit përcaktohet në formularin KD Model-4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.

Neni 14

Marrja e deklarimeve nga oficeri disiplinor

1. Thirrja e ushtarakëve që kanë dijeni për shkeljen disiplinore bëhet sipas formularit KD Model-5, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.
2. Para se të deklarojë, ushtaraku që ka dijeni i bëhet e ditur se, në rast se deklaron të dhëna të rreme, ai do të përgjigjet disiplinarisht për shkelje disiplinore të parashikuar nga shkronja “r”, e pikës 1, të neni 12, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
3. Dëshmitari kur thirret, sipas pikës 1, të këtij neni, është i detyruar të paraqitet. Nëse mos paraqitja dhe mungesa e tij nuk është e shkaktuar nga forca madhore, mosmarrja e njoftimit ose ndonjë pengesë tjetër e vlerësuar nga oficeri disiplinor, që e përjashton nga përgjegjësia, përbën shkelje disiplinore e parashikuar nga shkronja “rr”, e pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
4. Deklarata merret sipas formularit KD Model-6, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.

Neni 15

E drejta e ushtarakut për tu mbrojtur

1. Ushtaraku që ankohet gëzon të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të parashtruar prova dhe fakte në lidhje me pafajësinë e tij. Këtë të drejtë ushtaraku e ushtron personalisht.
2. Ushtaraku nuk mund të pengohet për mbledhjen e provave dhe fakteve që vërtetojnë pafajësinë e tij.

KREU III

FUNKSIONIMI I KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 16

Funksionet e komisionit disiplinor

Komisioni disiplinor është autoriteti që shqyrton ankimin për masat e rënda disiplinore dhe nëpërmjet fakteve dhe provave të dokumentuara merr vendim për lënien në fuqi, ndryshimin ose shfuqizimin masën disiplinore.

Neni 17

Procedura e komisionit disiplinor

1. Hapja e seancës, bëhet nga kryetari i komisionit duke ndjekur këtë procedurë:
 - a. hapet seanca e shqyrtimit të ankesës për masën e rëndë disiplinore;
 - b. verifikohet prania e anëtarëve dhe sekretarit të komisionit, oficerit disiplinor dhe ushtarakut që ka bërë ankim;
 - c. merren gjeneralitetet e ushtarakut që ka bërë ankim dhe të oficerit disiplinor;
 - ç. sigurohet paraqitja dhe shqyrtimin e paanshëm i provave dhe fakteve që sjellin palët;
 - d. i kujtohet ushtarakut e drejta për të kërkuar përjashtimin e anëtarëve të komisionit disiplinor, apo oficerit disiplinor nga procesi, kur gjykon se ekziston një nga rastet e nenit 10, të kësaj rregulloreje;
 - dh. i kujtohet ushtarakut e drejta për të mos dhënë përgjigje për pyetjet që i drejtohen.
2. Procedura e zhvillimit të seancës disiplinore.
 - a. parashtrimi, nga kryetari i komisionit, i masës së rëndë disiplinore të dhënë nga autoriteti përgjegjës;
 - b. parashtrimi i ankimit nga ushtaraku i ndëshkuar, i provave dhe fakteve ku mbështet ankimin si dhe kërkesa e tij në lidhje me objektin e gjykimit;
 - c. parashtrimi, nga oficeri disiplinor, i pretendimeve, i provave dhe fakteve ku është mbështetur dhënia e masës së rëndë disiplinore si dhe kërkesa e tij në lidhje me objektin e gjykimit;
 - ç. dëgjimi i dëshmitarëve dhe paraqitja e dokumenteve.
3. Gjatë seancës së shqyrtimit të ankimit kryetari dhe anëtarët e komisionit kanë të drejtë t'i drejtojnë pyetje ushtarakut ankues, oficerit disiplinor dhe dëshmitarëve. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe palët kundrejt njëra-tjetrës dhe dëshmitarëve.
4. Të gjitha zhvillimet gjatë seancës regjistrohen në procesverbal të mbajtur nga sekretari i komisionit disiplinor. Procesverbali nënshkruhet nga pjesëmarrësit në seancë.

Neni 18

Mungesa e ushtarakut ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore

1. Kur ushtaraku që ka bërë ankim nuk paraqitet në seancë dhe mungesa e tij është e shkaktuar nga forca madhore, mosmarrja e njoftimit ose ndonjë pengesë tjetër e vlerësuar nga komisioni që e përjashton nga përgjegjësia, komisioni disiplinor kryesisht, shtyn shqyrtimin disiplinor, duke caktuar datën dhe orën e seancës së re.

2. Kur ushtaraku që ka bërë ankim nuk paraqitet në seancë, pa patur shkaqe të ligjshme, largohet nga seanca, apo jep pëlqimin që procesi disiplinor të zhvillohet pa praninë e tij, procesi zhvillohet në mungesë.

Neni 19

Thirrja dhe pyetja e dëshmitarëve gjatë seancës

1. Dëshmitarët thirren nga komisioni disiplinor, kur kërkohet nga ushtaraku që ka bërë ankimin dhe/ose oficeri disiplinor.
2. Thirren si dëshmitarë vetëm personat që kanë qenë prezent në shkeljen disiplinore ose kanë dijeni për këtë shkelje.
3. Dëshmitarët pyeten veç e veç dhe vetëm për faktet që kanë lidhje me shkeljen disiplinore që shqyrtohet.
4. Dëshmitari nuk mund të dëshmojë për çka flitet në publik, të shprehë qëndrime personale apo të dëshmojë për qëndrim moral të ushtarakut ndaj të cilit është dhënë masë disiplinore.
5. Pyetja e dëshmitarëve bëhet fillimisht nga pala që e ka thirrur dëshmitarin. Më pas pyetja, nëse ka, vazhdon nga pala tjetër.
6. Dëshmitarit nuk i bëhen pyetje që ndikojnë në paanësinë e tij ose që synojnë sugjerim të përgjigjeve.
7. Para se të dëshmojë, dëshmitarit i bëhet e ditur se, në rast se dëshmon të dhëna të rreme, ai do të përgjigjet disiplinarisht për shkelje disiplinore të parashikuar nga shkronja “r”, e pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
8. Dëshmitari kur thirret, sipas pikës 1, të këtij neni, është i detyruar të paraqitet. Nëse mos paraqitja në seancë dhe mungesa e tij nuk është e shkaktuar nga forca madhore, mosmarrja e njoftimit ose ndonjë pengesë tjetër të vlerësuar nga komisioni që e përjashton nga përgjegjësia, përbën shkelje disiplinore e parashikuar nga shkronja “r”, e pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 20

Shtyrja e afatit të shqyrtimit disiplinor

Afati i shqyrtimit disiplinor mund të shtyhet për arsye madhore, për aq kohë sa zgjat shkak dhe bëhet nga autoriteti përgjegjës që ka urdhëruar ngritjen e komisionit disiplinor.

Neni 21

Marrja e vendimit nga komisioni disiplinor

1. Vendimi në komisionin disiplinor merret pa prezencën e personave të tjerë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.
2. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i bazuar në prova dhe në ligj.
3. Vendimi i komisionit disiplinor përmban:
 - a. përbërjen e komisionit disiplinor që ka dhënë vendimin;
 - b. gjeneralitetet e ushtarakut ankues ose të dhëna të tjera që vlejné për ta identifikuar dhe gjeneralitetet e oficerit disiplinor;
 - c. masën disiplinore që shqyrtohet;
 - ç. parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të fakteve dhe provave mbi të cilat është bazuar vendimi, si dhe arsyet pse provat e kundërta nuk janë pranuar nga komisioni.
 - d. vendimin e marrë për lënien në fuqi të masës së dhënë, ndryshimin apo shfuqizimin e saj. dh. datën dhe nënshkrimin e anëtarëve të komisionit.
4. Në rastin kur vendimi i komisionit përcakton ndryshimin e masës së rëndë disiplinore, atëherë masa e re duhet të jetë më e lehtë se masa e dhënë nga autoriteti përgjegjës.
5. Format i vendimit përcaktohet në formularin KD Model-7, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.
6. Zbardhja e vendimit të marrë nga komisioni disiplinor bëhet brenda dy ditësh nga përfundimi i procesit disiplinor.
7. Autoriteti përgjegjës brenda 3 ditësh, nga dita e zbardhjes së vendimit, të komisionit disiplinor, nxjerr urdhër për zbatimin e këtij vendimi.
8. Urdhri i komunikohet ushtarakut ankimues brenda 48 orëve.

Neni 22

Zbatimi i rregullores

1. Ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura janë të detyruar të zbatojë me përpikmëri dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje nga ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masave përkatëse disiplinore, sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

KËRKESË
PËR
NGRITJE KOMISIONI DISIPLINOR

Nr.____ Prot.,

Datë ____ . ____ . ____

Drejtuar: _____ (gradë, emër, mbiemër)

_____ (SHSHPFA /Komandant i Forcës/Strukturës Mbështetëse)

I nderuar Z. Gjeneral,

Unë i nënshkruari _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion), ju bëj me dije se me datë ____ . ____ . ____ më është komunikuar masa disiplinore “ _____ (emërtesa e masës) _____”, e dhënë nga eprori im _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion).

Sa më sipër, duke mos qenë dakord me masën disiplinore të dhënë ndaj personit tim, si dhe bazuar në nenin 7, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor”, kërkoj ngritjen e komisionit disiplinor për dëgjimin dhe shqyrtimin e ankesës time.

KËRKUESI

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Shënim: Një kopje e kërkesës, pasi protokollohet, i jepet kërkuesit.

KËRKESË
PËR
PËRJASHTIM ANËTARI OSE OFICERI DISIPLINOR

Nr. ____ Prot.,

Datë ____ . ____ . ____

Drejtuar: _____ *(SHSHPFA/Komandantit të Forcës/Strukturës Mbështetëse)*

I nderuar Z. Gjeneral,

Në bazë të nenit 10, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor”, kërkoj përjashtimin e _____ *(gradë, emër, mbiemër)*, i cili është *(kryetar/anëtar/oficer disiplinor)*, në komisionin disiplinor të ngritur ndaj personit tim, për shkak se _____ *(arsyeja e papajtueshmërisë)*

KËRKUESI

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Shënim: Një kopje e kërkesës, pasi protokollohet, i jepet kërkuesit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SHSHPFA/Komandanti i Forcës/Strukturës Mbështetëse

URDHËR

Nr. _____ Datë ____ . ____ . ____

PËR

**NGRITJEN E KOMISIONIT DISIPLINOR PËR SHQYRTIMIN E ANKIMIT NDAJ
MASËS DISIPLINORE _____ (emërtimi i masës) NË NGARKIM TË
_____ (gradë, emër, mbiemër)**

Në mbështetje të _____ (*Për SHSHPFA - nenit 15, pika 9, shkronja "sh"/ Për Forcat/Strukturat Mbështetëse - nenit 18, pika 5, shkronja "h"*), _____ të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 8, të ligjit nr. 173/2014 "Për disiplinën në Forcat e Armatosura të RSH",

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit disiplinor për shqyrtimin e ankimit ndaj masës disiplinore _____ (emërtimi i masës) _____, të dhënë nga _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion) _____, në ngarkim të _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion) _____

2. Komisioni të përbëhet nga:

1. _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion) _____, Kryetar
2. _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion) _____, Anëtar
3. _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion) _____, Anëtar
4. _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion) _____, Anëtar
5. _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion) _____, Anëtar

3. _____ (*gradë, emër, mbiemër, funksion*), caktohet oficer disiplinor.
4. _____ (*gradë, emër, mbiemër, funksion*), caktohet sekretar i komisionit disiplinor.
5. Komisioni disiplinor të nisë procedurën e shqyrtimit e ankimit ndaj masës disiplinore me datë __.__.____ dhe të marrë vendim brenda datës __.__.____.
6. Komisioni disiplinor të zhvillojë mbledhjet në _____ (*vendi ku do të zhvillohen mbledhjet*).
7. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri kryetari i komisionit disiplinor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

(SHSHPFA/ Komandanti i Forcës/Strukturës Mbështetëse)

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

PROÇESVERBAL

I NJOHJES ME AKTET

Nr. _____, Prot.

Datë, ____ . ____ . ____

Sot, me datë ____ . ____ . ____ në _____ (*vendi ku mbahet procesverbali*) _____, ora _____, në bazë të nenit 13, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor” mbahet ky procesverbal për njohjen e _____ (*gradë, emër, mbiemër, i ankuesit*) _____ me aktet e mbledhura gjatë hetimit disiplinor në lidhje me ankimin e bërë prej tij mbi masën disiplinore _____ (*emërtimi i masës*) _____”.

_____ (*gradë, emër, mbiemër i ankuesit*) _____ iu vunë në dispozicion aktet si më poshtë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

ANKUESI

(grada, emër, mbiemër, nënshkrimi)

OFICERI DISIPLINOR

(grada, emër, mbiemër, nënshkrimi)

Shënim: Një kopje e këtij procesverbali, pasi protokollohet, i jepet ankuesit.

FLETËNJOFTIM PËR MARRJE DEKLARIMESH

Nr _____ Prot.

Datë _____.____._____

Drejtuar: _____
(grada, emri, mbiemri)

Me adresë: _____
(adresa e plotë e punës, vendbanimit apo vendqëndrimit)
_____.

Bazuar në nenin 14, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor”, njoftoheni për t’u paraqitur më datë____.____._____, ora_____, në _____
(vendi ku do të merret deklaratata) _____, tek _____
(gradë, emër, mbiemër i oficerit disiplinor) _____ me numër zyre _____ dhe celulari _____.

Njoftimi për paraqitje bëhet pasi do të intervistoheni (deklaroni) lidhur me :
(Përshkruhet shkurtimisht arsyeja e paraqitjes)

_____.

OFICERI DISIPLINOR

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Data e dorëzimit _____.____._____.

Dorëzuesi i fletënjoftimit

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Marrësi i fletënjoftimit

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Shënim: Fletënjoftimi pasi nënshkruhet, i kthehet oficerit disiplinor personalisht nga marrësi.

DEKLARATË MBI ÇËSHTEJN DISIPLINORE

Nr. _____ Prot.

Datë ____ . ____ . ____

Mbajtur në _____ (*vendi ku mbahet deklarata*), më datë ____ . ____ . ____ , ora _____ , nga _____ (*gradë, emër, mbiemër*), oficer disiplinor, i caktuar me urdhër nr. _____ , datë ____ . ____ . ____ , të _____ (*SHSHPFA /Komandantit të Forcës/Strukturës Mbështetëse*).

Në bazë të nenit 14, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e komisionit të disiplinor”, marr deklarinimin e _____ (*gradë, emër, mbiemër, funksion*), mbajtës i dokumentit identifikues _____ në lidhje me rrethanat e shkeljes disiplinore të kryer nga _____ (*gradë, emër, mbiemër*).

Pasi iu shpjegua që në rast se deklaron të dhëna të rreme, ai do të përgjigjet disiplinarisht dhe pasi iu kërkua që të tregoj gjithçka di për rrethanat e çështjes, _____ (*gradë, emër, mbiemër*), deklaron si më poshtë:

Nuk kam gjë tjetër për të shtuar.

DEKLARUESI

OFICERI DISIPLINOR

(*gradë, emër, mbiemër, firmë*)

(*gradë, emër, mbiemër, firmë*)

Shënim: Një kopje e kësaj deklarate, pasi protokollohet, i jepet deklaruessit.

Për sa më sipër, komisioni disiplinor me _____ (unanimitet/shumicë votash)

VENDOSI:

(lënie në fuqi të masës disiplinore _____ (emërtimi i masës) _____ të dhënë ndaj ankuesit)

(ndryshimin e masës disiplinore _____ (emërtimi i masës) _____ të dhënë ndaj ankuesit,
me masën disiplinore _____ (emërtimi i masës) _____, të përcaktuar në
shkronjën ____, të pikës _____, të nenit 14, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e
Armatosura të Republikës së Shqipërisë”)

(shfuqizimin e masës disiplinore _____ (emërtimi i masës) _____ të dhënë ndaj ankuesit
dhe shpalljen e tij të pafajshëm)

Shpallur sot, me datë ____ . ____ . ____ .

Kryetari

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Anëtar

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Anëtar

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Anëtar

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Anëtar

(gradë, emër, mbiemër, firmë)